

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

BSC NË FINANCË KONTABILITET

OFRUAR NGA SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE, "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi

Dr. Valbona Kapllani




(Tetor/2016)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Financë-Kontabilitet

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	ShLUJ “Universiteti Marin Barleti”
2	Fakulteti që e ofron	Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Shkresë 2365 prot, datë 12.04.2006
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër , Nr. 288 dt. 04.09.2009
5	Titulli i programit të studimit:	Bsc në Financë-Kontabilitet
6	Cikli i studimit:	I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	kohë e plotë dhe të pjesshme
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2006-2007
	Etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim.



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Financë-kontabilitet

Programi i studimit Bachelor në Financë-kontabilitet është akredituar me urdhër nr. 288, dt. 04/09/2009, të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Në këtë urdhër programi në shqyrtim është akredituar si program i ciklit të parë të studimeve, me kohëzgjatje normale 3 vjet, me 180 kredite, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Financë-Kontabilitet, e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

KA dhe APAAL vendosën Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi dhe Dr. Valbona Kapllani si eksperte të jashtëm për këtë program studimi. GVJ është asistuar nga specialistja e APAAL Znj. Iva Lika.

Më datë 25.10.2016 dërgohet në institucion Draf Raporti i Jashtëm. Me shkresë Nr. 1465 Prot, datë 02.11.2016, Institucioni shpreh opinionin e tij në lidhje me paragrafin e fundit të Standardit III- Personeli i Institucionit.

Ekspertet u njohën me këtë opinion dhe tabelën shoqëruese, e cila sherbeu për të saktësuar se pedagogu Gjergji Dhima është aktualisht pedagog i brendshëm pranë Departamentit të Biznesit, Menaxhimit dhe Turizmit.

Si rezultat, i përlogaritjes mbi vlerat e reja të raportit pedagogë të brendshëm kundrejt pedagogëve gjithsej të angazhuar në programin e studimit objekt vlerësimi, ekspertët vendosën të rishikojnë vlerësimin lidhur me kërkesën e Standardit III- Personeli i Institucionit.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” (SHLUJ UMB) është institucion privat i arsimit të lartë, krijuar në bazë të ligjit nr. 8461, dt. 25/02/1999, i ndryshuar, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 9471, dt. 21/05/2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjet nr. 9832, dt. 12/11/2007, nr. 10307, dt. 22/07/2010, nr. 10493, dt. 15/12/2011 dhe aktet nënligjore bazuar në to, i ndryshuar, me ligjin nr. 80/2015, dt. 25/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky institucion, SHLUJ UMB, mbështetur në sa më sipër filloi veprimtarinë mësimore gjatë vitit akademik 2006-2007. Në përputhje me bazën ligjore, programet e ofruara nga SHLUJ UMB u përshtatën me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe gjithashtu dhe me parimet e Kartës së Bolonjës. SHLUJ UMB është akredituar si institucion me urdhërin nr. 288, dt. 04/09/2009, të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Me të njëjtin urdhër u akredituan dhe programet e studimit: Bachelor në Menaxhim Biznes, **Bachelor në Financë Kontabilitet**, Bachelor në Shkenca Politike dhe Bachelor në Drejtësi. Me urdhërin nr. 329, dt. 07/08/2012, të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, SHLUJ UMB, ka fituar akreditimin e programeve të studimit: Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Kontabilitet-Financë, Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Shërbime Bankare dhe Financiare, Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Marketing dhe Menaxhim Operacionesh, Master Profesional në Administrim Biznesi me profil Liderhip dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore, Master Profesional në Shkenca Politike me profil Administrim Publik, Master Profesional në Shkenca Juridike me profil E Drejtë Biznesi/Tregtare, Master Profesional në Shkenca Juridike me profil E Drejtë Publike.

Programi Bachelor në Financë-kontabilitet është akredituar bazuar në Urdhërin nr. 288, dt. 04/09/2009, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Programi manaxhohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, në bashkëpunim dhe me departamente të tjerë të fakultetit si edhe me Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, kryesisht për ofrimin e minorëve të cilët konsiderohen pjesë përbërëse e planit mësimor të Bachelorit në Financë Kontabilitet. Programi në shqyrtim është një program i ciklit të parë të studimeve i cili synon përvetësimin nga ana e studentëve të njohurive teorike mbi financën dhe kontabilitetin por të para këto ngushtësisht të lidhura me praktikën. Këtij qëllimi, forcimit të raportit teori-praktikë, i shërben jo vetëm përfshirja në kurrikulën e këtij programi i disiplinës së praktikës mësimore por në të njëjtën kohë sjellja e praktikës në auditor nëpërmjet ekspertëve më të mirë të fushave përkatëse, nëpërmjet leksioneve të hapura, etj. Programi Bachelor në Financë Kontabilitet është konceptuar bazuar në një kurrikul bazë, ndjekur

nga lëndët karakterizuese të fushës, pra të financës dhe të kontabilitetit dhe të kategorive të lëndëve me zgjedhje të cilat ofrohen përkatësisht në format e minorëve apo në format e profileve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Kriteri 3 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit.</p> <p>Kriteri 4 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ka objektiva të shprehura qartë, në funksion të përvetësimit të dijeve si dhe të formimit të kompetencave profesionale që lidhen me programin. Objektivi kryesor i këtij programi është transmetimi i njohurive mbi financën dhe kontabilitetin, të nevojshme në krijimin e financierëve, kontabilistëve apo analistëve të ardhshëm të financave të institucioneve private apo publike.</p> <p>Kriteri 5 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, përgatitjen e specialistëve të nevojshëm për kompani, ndërmarrje, organizata, etj.</p> <p>Kriteri 6 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo në sajë të ndihmës së dhënë nga ekspertët më të mirë të fushës së financës dhe asaj të kontabilitetit si edhe të konsultimit të kurrikulave më të mira perëndimore me fokus financë-kontabilitetin.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Kriteri 1 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe më konkretisht me Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit “Vizion 2020-Horizonte dhe perspektiva të reja për arsimin e lartë”.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet synon të pajisë studentët me njohuritë bazë të fushave të financës dhe të kontabilitetit, me metoda matjeje dhe parime të përgjithshme të këtyre fushave.</p> <p>Kriteri 3 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet synon dhe krijimin apo stimulimin e përfuturit të njohurive të veçanta për studentët nëpërmjet ofrimit të profileve apo të minorëve, të</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	mundshëm për tu përzgjedhur në këtë program studimi.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Kriteri 1 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet synon plotësimin e nevojave të tregut të punës për specialistë të financës apo të kontabilitetit, në përputhje me synimet e zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni për të vlerësuar nevojat e tregut të punës shfrytëzon bashkëpunimet e shumta që ka me institucione të ndryshme private dhe shtetërore të fushës; vlerëson dhe parashikon në mënyrë të përafërt numrin potencial të studentëve për tu regjistruar në këtë program studimi duke u mbështetur në takimet dhe intervistat e përvitshme me maturan të gjimnazeve kryesisht të Tiranës, por edhe të rretheve kryesore të vendit; si edhe analizon numrin e regjistrimeve të studentëve në programe me të njëjtin fokus, apo të përafërt, të universiteteve të tjera.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Kriteri 1 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, duke konsultuar kurrikulën që ofron, nuk bie ndesh me interesa kombëtare.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet synon të ndihmojë në ruajtjen dhe në zhvillimin e vlerave kombëtare.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, që ofrohet nga SHLUJ UMB, është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit të përcaktuar në Planin e Zhvillimit Strategjik “Vizion 2020”. Plani i Zhvillimit Strategjik është hartuar në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit të ofruara nga SHLUJ UMB, të rezultateve të mësimdhënies dhe nxënies në këto programe, etj. Ky program i studimit në shqyrtim është hartuar gjithashtu në përputhje me nevojat e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hartuar në përputhje me zhvillimet aktuale ekonomike, perspektivën e tyre dhe respekton vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në hartimin e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, është respektuar baza ligjore: aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: standardet në çështjen 1 “Misioni/Objektivat e programit të studimit” janë respektuar plotësisht.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi Bachelor në Financë dhe Kontabilitet ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë që është një ndër dy fakultetet e SHLUJ UMB, krahas qendrave kërkimore të cilat janë

pjesë e strukturës së IAL në shqyrtim. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë së bashku me Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale Politike është pjesë e SHLUJ UMB. Pjesë e kësaj IAL përveç 2 fakulteteve janë dhe tre qendra kërkimore. Programet e studimeve të ofruara nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ofrojnë mundësi për studime ekonomike në fushën e financë-kontabilitetit, të menaxhimit si dhe në fushën e shkencave kompjuterike dhe arkitekturës. Misioni i fakultetit realizohet nëpërmjet zhvillimit të programeve bachelor dhe master. Fakulteti Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë përbëhet nga tre departamente:

- Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm;
- Departamenti i Ekonomisë dhe Financës;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë është iniciuesi, hartuesi dhe përgjegjësi për administrimin e programit në shqyrtim: Bachelor në Financë Kontabilitet. Departamenti, njësia bazë mësimore dhe shkencore, drejtohet nga përgjegjësi i departamentit dhe planifikon shpërndarjen e mësimdhënies ndërmjet pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm. Departamenti përgjegjës për manaxhimin e programit të studimit është Departamenti i Ekonomisë dhe Financës. Organi kolegjal vendimmarrës i fakultetit është Këshilli i Fakultetit (KF), i cili diskuton dhe vendos në lidhje me problemet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit. Anëtarët e KF përfaqësojnë personelin akademik të fakultetit. Si rregull përgjegjësit e departamenteve janë anëtarë të KF. Dekani i fakultetit është anëtar dhe kryetar i KF për shkak të detyrës. Ai gjithashtu përfaqëson fakultetin në senat. Dekani është drejtuesi kryesor i fakultetit. Këshilli shkencor është organi epror kolegjal i fakultetit. Ai merr në shqyrtim dhe vendos për problemet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit. Njësi të tjera mbështetëse të procesit mësimor, kërkimit shkencor, etj në SHLUJ UMB janë: sekretaria mësimore, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e projekteve, Zyra e orientimit të studentëve, Zyra e karrierës, Zyra Alumni, biblioteka, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.

Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik përveç detyrave që rrjedhin nga procesi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor angazhohet edhe në veprimtari të tjera si këshillim dhe mbikëqyrje për studentët, detyra administrative në përputhje me kërkesat e përcaktuara në statutin e SHLUJ UMB dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës, e cila bazohet në Kodin e Punës të RSH. Angazhimi i personelit akademik në UMB është me kohë të plotë ose të pjesshme.

Politikat e rekrutimit të stafit akademik shqyrtohen dhe miratohen nga Bordi i SHLUJ UMB-së, i cili ia delegon Rektorit për ndjekje dhe zgjidhje, çështjet konkrete të tyre, në interes të mbarëvajtjes së punës, efektivitetit dhe operativitetit të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore. Punësimi i stafit akademik kryhet sipas procedurave, kërkesave arsimore dhe të kualifikimit, të miratuara nga Bordi, mbi bazën e propozimeve të Senatit të Universitetit. Vendet e lira të punës si dhe kriteret e konkurimit propozohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Në SHLUJ UMB funksionon zyra e burimeve njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin si dhe për vendet e lira të punës, kjo zyrë ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunon të dhënat, etj. Vlerësimi i kandidatave të paraqitura bazohet kryesisht në kriteret e mëposhtme:

- Diplomë (e ciklit të parë të studimeve) e përshtatshme me disziplinën apo fushën akademike, ku është shpallur vendi i lirë;
- Tituj e grada shkencore;
- Përvojë pune, përparësi përvoja në mësimdhënie;
- Kompetenca profesionale në mësimdhënie apo kërkim;
- Botime, arritje krijuese, shërbime të dallueshme profesionale;
- Dëshmi të gjuhëve të huaja, me përparësi gjuha angleze;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe dëshirë për punë në ekip;
- Integritet moral dhe profesional.

SHLUJ UMB ka të punësuar në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë 41 pedagogë, nga të cilët 22 janë PAE dhe 19 PAK. Ndarja e tyre sipas titujve dhe gradave jepet në tabelat 1, 2 dhe 3 në anekset 1, 2, dhe 3 shoqëruese të këtij raporti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit
- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat Aneksi 1/2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelën, Aneksi 3)
- Të dhënat sipas seksit
- Të dhëna sipas moshës së personelit
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - **Përditësimi i të gjitha tabelave në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.**

Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (Tabela 1 dhe 2 në RVB). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (Tabela 1 dhe 2 në Aneksin 1 dhe 2 bashkangjitur këtij Raporti).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedurat ligjore për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me statutin dhe rregulloren e tij. Thirrjet për rekrutim të stafit janë transparente për të interesuarit dhe pasqyrohen si në faqen web të institucionit ashtu dhe në mjete të tjera të komunikimit: shtypin e shkruar, etj.</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 70% të personelit të angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet (16 pedagogë të brendshëm të institucionit dhe 7 pedagogë me kontratë).</p> <p>Kriteri 3 Në institucion ndiqen disa procedura për një vlerësim sa më të saktë të personelit akademik. Ndër to mund të përmendim plotësimin e formularit të vetëvlerësimit nga pedagogët, anketimin e studentëve në lidhje me vlerësimin e pedagogut dhe lëndës për të cilën ai është përgjegjës, etj. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të stafit paraqiten në mënyrë të detajuar në manualin e rekrutimit të stafit.</p> <p>Kriteri 4 Në institucion zyra e burimeve njerëzore është hallka përgjegjëse për inventarizimin e të</p>

	<p>dhënave të stafit akademik, rekrutimin e stafit të ri, etj. Në këtë zyrë baza e të dhënave në lidhje me personelin akademik ruhet në të dy formatet: në atë hard copy (shkresor) dhe në atë elektronik.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të saktë të të dhënave në lidhje me stafin akademik (efektiv dhe me kontratë) të përfshirë në mësimdhënie në programin Bachelor në Financë Kontabilitet si edhe për personin përgjegjës për këtë program studimi, i cili është përgjegjësi i Departamentit të Ekonomisë dhe Financës, meqenëse është ky departamenti që manaxhon dhe mban përgjegjësi për këtë program studimi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e personelit akademik, efektiv dhe me kontratë, sipas shpërndarjes semestrale përgjatë një viti akademik. Ndërkohë që personeli ndihmës mësimor shkencor dhe ai administrativ janë përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha programeve, përfshirë edhe programin në shqyrtim, të cilat zhvillohen pranë kampusit numër 1.</p> <p>Kriteri 3 Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në statutin e institucionit dhe publikohen në faqen web të tij. Në statut përfshihen kryesisht kriteret e përgjithshme. Ndërsa kriteret më specifike në lidhje me njoftime individuale përcaktohen nga departamenti përgjegjës për manaxhimin e këtij programi, pra nga Departamenti i Ekonomisë dhe Financës dhe nga përgjegjësi i tij.</p> <p>Kriteri 4 Në përgjithësi stafi i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, referuar vitit akademik 2015-2016, ka qenë kryesisht me gradën doktor. Edhe ato pak pedagogë (efektivë apo me kontratë) të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi që nuk e kanë këtë gradë, janë studentë në Shkolla Doktorature dhe janë në procesin drejt mbrojtjes së saj.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve</p>	<p>Kriteri 1 Personeli ndihmës mësimor-shkencor i angazhuar në ndihmë të realizimit të orëve të laboratorit, mirëmbajtjes së laboreve dhe ambienteve shkollore të kampusit numër 1 të SHLUJ Marin Barleti, këtë funksion e kryen për të gjitha programet që zhvillohen në këtë kampus, përfshirë edhe programin e marrë në shqyrtim në këtë RVJ.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni tregon angazhimin maksimal për përmbushjen e objektivave të programit të studimit në shqyrtim në këtë RVJ, programit të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dhe më konkretisht departamenti</p>

<p>në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>që manaxhon këtë program studimi ka dhe vë në dispozicion të udhëheqjes së studentëve në praktika profesionale, pedagogët e tij. Respektohet plotësisht limiti i udhëheqjeve i vendosur për një pedagog në këtë standard duke marrë në konsideratë numrin relativisht të kufizuar të studentëve të regjistruar në vite në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni stimulon kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik me forma nga më të ndryshme: organizimit të konferencave vjetore të vetë institucionit, stimulimit të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të pedagogëve, pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe shkrimin e artikujve për botim në revista vendase apo të huaja, organizimit të trajnimeve të ndryshme me profesorë vendas apo të huaj, nxitjes dhe stimulimit për aplikim në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit, nxitje të mobilitetit të pedagogëve në kuadër të programeve Erasmus+, etj. Kriteri 2 Institucioni disponon dhe na ofroi të dhënat në lidhje me aktivitetet e ofruara në funksion të qëllimit të standardit III.4, pra të kualifikimit të vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij akademik.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: SHLUJ UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e stafit duke u bazuar në statutin dhe rregulloren e institucionit. Gjithashtu institucioni ndjek procedura të vlerësimit të personelit bazuar në dokumentin e Politikës së Vlerësimit. Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me: personelin e punësuar, procedurat e rekrutimit, vlerësimin e personelit, kualifikimin shkencor të tij, etj. Gjatë vizitës, u njoftuam se një pedagoge e punësuar me kohë të plotë, znj. M. Berdo, ishte larguar nga institucioni për tu punësuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, pak kohë para vizitës sonë në institucion. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që kontribuon në realizimin e programit të studimit në shqyrtim aktualisht përbën 70% të personelit të angazhuar në total në këtë program studimi (raporti i përlllogaritur bazuar në numrin e pedagogë të brendshëm të institucionit 16 kundrejt 23 pedagogëve gjithsej të angazhuar në këtë program studimi). Institucioni ka vijuar me procesin e publikimit të vendit vakant, ndërsa znj. M. Berdo do të vijojë kontributin pranë Institucionit si pedagoge me kontratë. Mbetet problem edhe për SHLUJ UMB gjetja dhe punësimi i stafit akademik me tituj/grada, fusha e studimit të cilëve të përputhet me fushën e studimit të këtij programi studimi dhe që mund të angazhohen pranë institucionit me kontrata afatgjata pune. Synimi i institucionit në rekrutimin e stafit është pikërisht sigurimi i ekspertëve me tituj/grada që mund të punësohen në afatmesëm/afatgjatë pranë institucionit. Realizimi i këtij synimi do të ishte garanci për qendrueshmërinë e stafit akademik të angazhuar me kohë të plotë në një periudhë kohe relativisht të konsiderueshme. Mbeten gjithashtu problem vështirësitë që hasin pedagogët e rinj të brendshëm të angazhuar në këtë program studimi, për tu regjistruar në studime doktoraturë. Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: standardet në çështjen 3 “Personeli i institucionit” janë respektuar plotësisht.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

SHLUJ UMB e ka selinë në adresën: Rr."Sami Frashëri", Nr 41, Tiranë. Aktiviteti mësimor zhvillohet në dy godina kryesore të cilat ndodhen përkatësisht në kampusin nr. 1 pranë Parkut Kombëtar ku zhvillohet mësimi në nivelin bachelor dhe në kampusin nr. 2 në periferinë e Selitës ku zhvillohet mësimi në nivelin master. Kampusi nr. 1 zotëron sipërfaqe parkimi. Programi i studimit në shqyrtim, Bachelor në Financë Kontabilitet zhvillon të gjithë aktivitetin mësimor pranë Kampusit nr. 1.

SHLUJ UMB ofron, në Kampusin nr. 1, për studentët shërbimin e bibliotekës, e cila përveç titujve dhe periodikëve në format letër ofron për studentët edhe shfrytëzimin e informacionit në format elektronik. Në këtë kampus ndodhen gjithashtu shërbimi i fotokopjes dhe mensës. Në këtë godinë ndodhen gjithashtu edhe zyrat që i vijnë në ndihmë studentëve me shërbimet që ofrojnë. Ato janë: zyra e rekrutimit, zyra e këshillimit të karrierë, dekani i studentëve, etj.

Të gjitha ambjentet mësimore (auditorë/klasa seminaresh/laboratorë) janë të pajisur me mjete të teknologjisë së informacionit të cilat lehtësojnë dhe përmirësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies (për treguesit e matshëm shih Tabelën 4 në Aneksin 4 bashkëlidhur këtij raporti).

Institucioni nuk ofron mundësinë e konvikteve të studentëve por ndihmon studentët në akomodimin më të përshtatshëm për ta, duke ofruar informacion në lidhje me mundësi të ndryshme të sistemimit për ta, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Kriteri 1 SHLUJ Marin Barleti ka vendosur në dispozicion të studentëve dy biblioteka, nga një në secilin kampus. Studentët e programit të studimit në shqyrtim kanë mundësi të tërheqjes së teksteve në të dy bibliotekat si dhe të përdorimit të bibliotekës online brenda ambienteve të kampuseve.</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekat e institucionit literatura që mund të konsultojnë studentët, ajo bazë, ndihmëse apo në funksion të projekteve apo punimeve të kursit është e konsiderueshme.</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekat e institucionit literatura që mund të konsultojnë studentët është e shumëllojshme. Mund të rendisim këtu: literaturën hard copy që mund të konsultohet si në ambjentet e bibliotekave ashtu dhe ambjente të tjera studimi nga ana e studentëve, literaturë online në formën e teksteve apo periodikëve të fushës së financë-kontabilitetit, etj.</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësi i programit të studimit në shqyrtim harton, bazuar në kërkesat e pedagogëve të lëndëve, një listë të titujve që duhen shtuar në funksion të zhvillimit të këtij programi studimi. Programi i studimit në fakt kishte një strukturë të qendrueshme dhe kostante të lëndëve për një periudhë të konsiderueshme kohore por mbështetja e këtij programi në një literaturë bashkëkohore, në përputhje të nevojave dhe kërkesave të tregut, është për tu konsideruar si një pikë e fortë e manaxhimit të programit, nga ana e pedagogëve përgjegjës të lëndëve, përgjegjësit të departamentit, si dhe institucionit i cili realizon përmbushjen e kërkesave dhe nevojave me literaturë bashkëkohore për këtë program studimi.</p> <p>Kriteri 5 Bibliotekat në të dy kampuset kanë të shpallura oraret e tyre të shërbimit. Këto orare janë të shpallura gjithashtu dhe në faqen http://www.umb.edu.al/umb-library.html të</p>

	<p>institucionit. Orari i shërbimit është 9.00-16.00, nga e hëna-të premte dhe është një orar shumë i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e programit të studimit në shqyrtim në këtë RVJ.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni SHLUJ UMB zhvillon aktivitetin e tij në dy kampuse por zhvillimi i programit të studimit në shqyrtim zhvillohet vetëm në kampusin numër 1, i cili ndodhet pranë Parkut Kombëtar të Tiranës. Në ambjentet e këtij kampusi ndodhen salla për zhvillimin e leksioneve, klasa për zhvillimin e seminareve, laboratorë, të mjaftueshëm në numër për zhvillimin e mësimit për studentët e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Këto ambjente janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e mësimit sipas metodave bashkëkohore.</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore në kampusin 1 janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimit dhe për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të programit të studimit në shqyrtim.</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët janë të pajisur me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e mësimit në përputhje me nevojat që mund të paraqiten në lëndë pjesë të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni është i pajisur me disa laboratorë, të cilët përdoren në varësi të nevojave të pedagogëve. Kështu mund të përmendim laboratorë të dedikuar për zhvillimin e lëndës së teknologjisë së informacionit si edhe laboratorë të cilët mund të përdoren për lëndë të tjera të veçanta, si gjuhë e huaj, statistikë, metoda të kërkimit shkencor, etj.</p> <p>Kriteri 5 Laboratorët e institucionit janë të pajisur me kompjutera dhe pajisje të nevojshme të teknologjisë së informacionit me synim zhvillimin me metoda sa më bashkëkohore të lëndëve të tilla si: informatikë, statistikë, metoda të kërkimit shkencor, etj, në kurrikulat e të cilave konsiderohet element i rëndësishëm dhe i domosdoshëm zhvillimi i orëve laboratorike.</p> <p>Kriteri 6 SHLUJ UMB garanton jo vetëm kapacitete pedagogjike, administrative të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve të programit Bachelor në Financë Kontabilitet por edhe kapacitete të mjaftueshme mjedisore për zhvillimin e tyre. Këtë gjë institucioni e realizon në bashkëpunim me disa institucione të fushës me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme në vite. Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga</p>

	institucioni nuk kanë në fokus vetëm lehtësimin e zhvillimit të praktikave nga ana e studentëve në fund të nivelit të parë të studimeve, por edhe ofrimin e leksioneve të hapura nga ekspertë të fushës përgjatë programit të studimit, lehtësimin e afrimit të studentëve me tregun e punës, etj.
Konkluzione të GVJ: SHLUJ UMB ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e këtij programi studimi. Procesi mësimor në këtë program studimi zhvillohet në kampusin 1 të institucionit. Në funksion të këtij programi studimi vendosen në dispozicion të studentëve bibliotekat e institucionit. Institucioni vendos në funksion të studentëve mjedise të përshtatshme mësimore, laboratorë të mjaftueshëm në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor dhe zhvillimit të detyrave/projekteve të kursit, punëve laboratorike, etj. Pajisjet në to janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimin në përputhje me kërkesat e programit në shqyrtim. Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: standardet në çështjen 4 “Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit” janë respektuar plotësisht.	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

SHLUJ UMB është një shoqëri aksionere që zhvillon veprimtarinë e saj në fushën e arsimit të lartë. Si shoqëri tregtare, bazuar në kërkesat e legjislacionit përkatës UMB sh.a harton dhe publikon pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Çdo vit këto pasqyra i nënshtrohen vlerësimit të ekspertit kontabël të autorizuar për vërtetësinë dhe sinqeritetin e informacionit të paraqitur në to. Gjithashtu, si pjesë e grupit ekonomik të shoqërive tregtare “Dudaj”, UMB sha është objekt i auditimi periodik edhe nga audituesit e grupit “Dudaj”.

Të ardhurat kryesore realizohen nga tarifat e shkollimit që paguajnë studentët të cilët zgjedhin të ndjekin studimet e tyre pranë SHLUJ UMB. Një pjesë tjetër e të ardhurave realizohet nga aktivitetet e shërbimit, të konsulencës dhe trainimit. Informacioni financiar i paraqitur në RVB dhe i marrë gjatë vizitave nga GVJ është në nivel Institucioni dhe jo specifik për programin e studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet. Për vlerësimin e treguesve të matshëm shih Tabelën 5 të Aneksit 5 bashkëlidhur këtij raporti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet

- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
 - Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
 - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
 - Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
 - Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- **Letër Suporti nga Investitori.**

Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjëndjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Kriteri 1 UMB sha harton dhe publikon pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Çdo vit këto pasqyra i nënshtrohen vlerësimit të ekspertit kontabël të autorizuar për vërtetësinë dhe sinqeritetin e informacionit të paraqitur në to.</p> <p>Kriteri 2 Gjatë vizitës dhe bisedave rezultoi se kancelari së bashku me audituesin e brendshëm të grupit “Dudaj” përgatisin një raport të auditimit të brendshëm për gjithë situatën financiare të SHLUJ UMB.</p> <p>Kriteri 3 Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare i referohet të gjithë institucionit si një njësi e vetme. Edhe raportet e audituesit të jashtëm dhe audituesit të grupit “Dudaj” analizojnë situatën financiare në nivel institucioni dhe jo sipas programeve apo ciklit të studimeve.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara</p>	<p>Kriteri 1 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (bazuar në klasifikimin sipas natyrës) evidenton të gjitha të ardhurat e realizuara dhe të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën ushtrimore në nivel institucioni. Gjatë vizitës dhe bisedave nuk rezultoi që të përgatitej ndonjë raport financiar tjetër mbi baza programi apo cikli studimesh.</p> <p>Kriteri 2 SHLUJ UMB është një shoqëri aksionere e</p>

<p>akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>cila dokumenton dhe ruan informacione financiare në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe kërkesat specifike të legjislacionit për shoqëritë tregtare.</p> <p>Kriteri 3 Investimet në infrastrukturë kanë krijuar kushte të nivelit bashkëkohor për procesin e mësimi dhe të kërkimit. Informacioni financiar i publikuar dhe mbështetja nga grupi tregtar “Dudaj” dëshmojnë për qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare të kënaqshme për të ardhmen.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>SHLUJ UMB sha harton dhe publikon pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Çdo vit këto pasqyra i nënshtrohen vlerësimit të ekspertit kontabël të autorizuar dhe audituesit të grupit “Dudaj”. Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare, analiza e shpenzimeve dhe raportet e auditimit i referohen të gjithë institucionit si një njësi e vetme. Megjithëse nuk përgatiten raporte financiare mbi baza programi apo cikli studimesh, mbështetja e grupit tregtar “Dudaj” është tregues i qartë i vijimësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të institucionit.</p> <p>Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: standardet në çështjen 5 “Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare” janë respektuar plotësisht.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Për garantimin e cilësisë, respektimin e standardeve, SHLUJ UMB ka përgatitur dhe miratuar dokumentin e Politikës së Vlerësimit dhe ka krijuar organizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në dokumentin e politikës së vlerësimit përmbledhen kriteret e sigurimit të cilësisë, funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë dhe procedurat e vlerësimit të brendshëm. Vlerësimi i brendshëm përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të të diplomuarve, intervistat me pedagogë dhe studentë, etj. Procesi përmbyllet me një raport që analizon gjendjen e institucionit në tërësi si dhe të programeve individuale të studimit në veçanti përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. Vlerësimi i brendshëm institucional, bazuar në Politikën e Vlerësimit, kryhet çdo tre vjet. Vlerësimi i programeve realizohet çdo dy vjet, vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies çdo vit, vlerësimi i pedagogëve çdo vit dhe vlerësimi i stafit administrativ çdo dy vjet. Në dokumentin e Politikës së Vlerësimit parashikohet dhe procedura e vetëvlerësimit të pedagogëve, procedurë e konsideruar si një mënyrë reflektimi dhe vetëanalize. Personeli akademik stimulohet që të përgatisë një raport vetëvlerësimi një herë në vit në të cilin përshkruhet veprimtaria e tij në procesin mësimdhënës, në aktivitetin kërkimor dhe shkencor, në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, në aktivitete të tjera mbështetëse të institucionit, etj.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë vepron Njësia e SBC e cila përbëhet në SHLUJ UMB nga dy seksione: ai që përgjigjet për programet bachelor dhe ai që përgjigjet për programet master. Njësia e SBC ka autonomi vepruese dhe të drejtë në përdorim të të gjitha të dhënave të SHLUJ UMB. Qëllimi kryesor i funksionimit të saj është arritja dhe garantimi i nivelit të një cilësie të lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore në SHLUJ UMB. Funksionet kryesore në të cilat fokusohet Njësia e SBC janë: në fushën e sigurimit të cilësisë, në fushën e akreditimit, në fushën e kërkimit dhe zhvillimit, etj. Raportet e përgatitura nga Njësia e SBC diskutohen në të gjitha hallkat institucionale të interesuara. Në SHLUJ UMB është krijuar dhe funksionon dhe Këshilli i Sigurimit të Cilësisë (KSC), i cili është krijuar dhe funksionon në nivel institucioni dhe ka përgjegjësinë e garantimit të plotësimit të standardeve të cilësisë në institucion. KSC raporton drejtëpërdrejt në Senat.

SHLUJ UMB i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional, proceseve të vlerësimit të jashtëm si dhe akreditimit të disa programeve në nivel bachelor dhe master. Për vlerësimin e treguesve të matshëm shih Tabelat 6 dhe 6.1 të Aneksit 6 që shoqëron këtë raport.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj
- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

➤ Statistikë për Transferimet nga dhe drejt Programit.

Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (Tabela 4 në RVB). Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (tabela 4 në Aneksin 4 bashkangjitur këtij Raporti)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	

<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>Kriteri 1 Institucioni vlerëson periodikisht ecurinë e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Kështu dy herë në vit, pothuajse në fund të semestrit organizohet anketimi i studentëve në lidhje me lëndën dhe pedagogun. Gjithashtu njëherë në vit, kryesisht për vit kalendarik, plotësohen nga ana e pedagogëve formularët e vetëvlerësimit. Pikërisht këto informacione janë pjesë e vlerësimit në departament të punës së secilit anëtar të stafit akademik, vlerësim i cili përcillet më pas në hallkat e mëpasshme të hierarkisë.</p> <p>Kriteri 2 Ky informacion më pas përfshihet në raportin e vlerësimit të institucionit i cili përcillet në senat dhe është pjesë e diskutimeve në të.</p> <p>Kriteri 3 Rezultatet e vlerësimeve janë jo vetëm pjesë e diskutimeve dhe analizave në të gjitha hallkat e institucionit por publikohen dhe në faqen e institucionit në mënyrë që me to të mund të njihen jo vetëm studentët aktualë të programit të studimit në shqyrtim por dhe kandidatët potencialë për tu regjistruar në këtë program. Kështu konkretisht RVB i hartuar për programin Bachelor në Financë Kontabilitet është i publikuar në faqen web të institucionit.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor metoda të vlerësimit të drejtpërdrejta si edhe metoda të vlerësimit të tërthortë. Në metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit mund të përmendim anketimin e studentëve për shumë elementë të programit të studimit si për shembull: programi, cilësia e mësimdhënies, etj. Mund të përmendim gjithashtu anketimin e studentëve të diplomuar në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, intervista të studentëve, etj. Ndërsa në metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit mund të përmendim: testimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare, vlerësim të detyrave të ndryshme të kryera nga studentët, si detyra kursi, etj, apo dhe vlerësimet gjatë kohës së kryerjes së praktikës mësimore, etj.</p>
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p> <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni përpara aplikimit për akreditim të këtij programi studimi ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë analizon dhe</p>

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

kontrollon cilësinë e programit të studimit duke përdorur të gjithë instrumentat e nevojshëm për sigurimin e saj.

Kriteri 3 Aktiviteti i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbështetet mbi dokumentin e hartuar nga institucioni. Ky dokument i njohur si Dokument i Politikës së Vlerësimit, përcakton procedurat dhe mjetet, si dhe frekuencën e përdorimit të tyre, për të garantuar sigurimin e cilësisë si edhe standardin e programeve.

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma të njohur dhe të përshkruar dhe në Dokumentin e Politikës së Vlerësimit, për të miratuar dhe më pas për të mbikëqyrur në mënyrë periodike (me frekuencat e përmendura më sipër) programin e studimit në shqyrtim.

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e studentëve si edhe të personelit në lidhje me rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të saj në këtë program studimi. Për këtë qëllim synohet anketimi i një numri të konsiderueshëm studentësh në fund të çdo semestri në mënyrë që rezultati i anketimit të jetë sa më i besueshëm. Mesatarisht përqindja e studentëve të anketuar ka qenë rreth 70%. Të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm publikohen në faqen e institucionit në mënyrë që studentët të jenë të njohur me vlerësimet periodike të institucionit.

Kriteri 6 Institucioni ka hartuar dhe zbaton strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kështu institucioni ka hartuar, zbaton dhe ka të publikuar në faqen web të tij dokumentin e Politikës së Vlerësimit, dokument në të cilin janë përcaktuar kriteret e sigurimit të cilësisë, funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë si edhe procedurat e vlerësimit të brendshëm.

Konkluzione të GVJ: SHLUJ UMB përdor metoda të vlerësimit, instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Informacioni i përfutur përfshihet në vetëvlerësimin institucional të cilësisë së institucionit, në raporte vjetore të vitit akademik, etj. Informacionet e përfuara publikohen por edhe diskutohen në të gjitha hallkat e fakultetit dhe më gjerë. Të gjitha sa më sipër i shërbejnë procesit të përmirësimin dhe evoluimit të programit të studimit në shqyrtim. Të gjithë elementët dhe procedurat e përdorura për vlerësimin e brendshëm apo për vetëvlerësim janë të përmbledhura në një dokument të hartuar nga SHLUJ UMB dhe të njohur si Politika e Vlerësimit.

Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: **standardet në çështjen 6 "Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë" janë respektuar plotësisht.**

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, është një program i ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, i ofruar nga SHLUJ UMB. Deri para dy viteve, programi i studimit është ofruar edhe në formën e studimeve me kohë të pjesshme. Ky program synon ndërthurjen e njohurive teorike nga fusha e financës dhe kontabilitetit, por të para këto ngushtësisht të lidhura me praktikën me qëllim përgatitjen e specialistëve të aftë për të menaxhuar dhe analizuar në mënyrë eficiente veprimtaritë e ndryshme të bizneseve. Këtij qëllimi, forcimit të raportit teori-praktikë, i shërben jo vetëm përfshirja në kurrikulën e këtij programi i disiplinës së praktikës mësimore por në të njëjtën kohë sjellja e praktikës në auditor nëpërmjet ekspertëve më të mirë të fushave përkatëse, nëpërmjet leksioneve të hapura, etj. Programi Bachelor në Financë Kontabilitet është konceptuar bazuar në një kurrikul bazë, ndjekur nga lëndët karakterizuese të fushës, pra të financës dhe të kontabilitetit dhe të kategorive të lëndëve me zgjedhje të cilat ofrohen përkatësisht në format e minorëve apo në format e profileve. Planu mësimor për këtë program studimi siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore, ndërmjet viteve dhe brenda vitit ndërmjet semestrave. Për përfitim të diplomës në këtë program studimi, studentët duhet të realizojnë 180 kredite, të cilat mund të përmbushen minimalisht në tre vite ose gjashtë semestra. Gjatë 2 viteve të parë të studimeve zhvillohen 20 lëndë, ndërsa në vitin e tretë zhvillohen nëntë lëndë, praktika pranë sipërmarrjes si dhe punimi i diplomës, i cili mund të zhvillohet në formën e provimit të formimit ose punimit të diplomës. Kufiri ndarës ndërmjet dy kategorive (provim formimi apo punim diplome) është nota mesatare e studentëve (mbi 9.5 mbrojtja kryhet me punim diplome). Studentët në fillim të çdo semestri informohen mbi lëndët që do të zhvillojnë nëpërmjet syllabuseve të përgatitura sipas standardeve të SHLUJ UMB.

Shënim: Sa më sipër vlen edhe për programin e studimit bachelor në Financë dhe Kontabilitet me kohë të pjesshme tashmë të mbyllur. Ndryshimi ndërmjet sistemit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme i referohet vetëm logjistikës së organizimit: studentët e sistemit me kohë të pjesshme zhvillojnë mësimin pjesë e mbetur nga regjistrimet e dy viteve më parë) në fundjavë përkatësisht ditën e premte nga ora 16.00-20.00 dhe ditën e shtunë nga ora 8.30-14.30. Sipas vendimit të Senatit të SHLUJ UMB ngarkesa e mësimdhënies në këtë program ishte 60% e ngarkesës së programit me kohë të plotë duke e organizuar mësimin me më shumë kohë në

dispozicion për punë jashtë auditorit (vendimi 2/11 datë 7/4/2011). Viti akademik për këtë sistem fillonte më 1 nëntor dhe përfundonte më 31 tetor të vitit pasues (zhvillohej në 42 javë mësimore ose 21 javë/semestër.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet synon ndërthurjen e njohurive teorike nga fusha e financës dhe kontabilitetit, por të para këto ngushtësisht të lidhura me praktikën me qëllim përgatitjen e specialistëve të aftë për të menaxhuar dhe analizuar në mënyrë eficiente veprimtaritë e ndryshme të bizneseve.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Organizimi i programit të studimit sipave viteve dhe semestrave jepet në tabelën 7 të Ankesit 7 bashkëlidhur në fund të këtij raporti.

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është i organizuar në module dhe lëndë, të cilat janë të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese jepet në tabelën 7.1 të Aneksit 7 bashkëlidhur në fund të këtij raporti.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 90 orë në auditor dhe 10 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 125 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Ndryshimet e paraqitura në Tabelën 7.2 të Aneksit 7 në fund të këtij raporti, i referohen krahasimit me planin mësimor të vitit 2009. Ndryshimet kryesisht lidhen me riorganizimin /zëvendësimin e disa lëndëve në lëndë/module të reja, semestrin e zhvillimit dhe në vlerësimin e krediteve. Këto ndryshime janë bërë për të reflektuar si duhet ndryshimet në kërkesat ligjore për organizimin e këtij niveli studimi. Gjatë periudhës 2011-2016 nuk ka pasur ndryshime në planet mësimore. Ndryshimet në nivel syllabusi janë minimale dhe kryesisht lidhen me përditësimin e literaturës bazë ose të rekomanduar me botimet më të fundit.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Planet mësimore të lidhura me personelin përkatës paraqiten në Tabelën 7.3 të Aneksit 7 në fund të këtij raporti.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

- **Plani mësimor i vitit 2009 dhe plani mësimor i vitit 2011;**
- **Profilet dhe minoret e ofruara në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet;**
- **Dy syllabuse që kanë pësuar ndryshime gjatë periudhës 2011-2016;**
- **Model i aprovuar i Diplomës dhe Supplementit;**
- **Dokumenta të kërkuara nga Sekretaria.**

Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues (tabelat 7 – 7.3 në Aneksin 7 bashkangjitur këtij Raporti).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Kriteri 1 Programi në shqyrtim Bachelor në Financë Kontabilitet është një program i akredituar me urdhër nr. 288 dt. 04/09/2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Programi është i organizuar në lëndë/module të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Kriteri 2 Sasia e krediteve që mund të grumbullohen në çdo vit akademik nga një student</p>

	që ndjek këtë program studimi, bazuar në planin mësimor, është 60 kredite/vit.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Kriteri 1 Informacionet në lidhje me programin në shqyrtim jepen në institucion jo vetëm nga pedagogët e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, por dhe pedagogët e departamenteve të tjera, meqenëse në planin mësimor të këtij programi janë projektuar dhe minorët të cilët përfshijnë edhe lëndë të departamenteve apo fakulteteve të tjera. Informacionet në lidhje me programin e studimit jepen edhe nga Zyra e Pranimit të Studentëve si edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Informacionet konsistojnë jo vetëm në strukturën e këtij programi pra lëndë/module, etj, por edhe në elementë të tjerë të rëndësishëm si pedagogët mësimdhënës, CV e tyre, elementë të planit mësimor si minor/profile, praktika, provim formimi/diplomë, etj.</p> <p>Kriteri 2 Të gjitha njësitë e përmendura dhe në kriterin 1, por kryesisht departamenti përgjegjës për këtë program studimi, japin informacionet në lidhje me lëndët (të thjeshta apo modulare) të cilat janë të vendosura në plan mësimor si lëndë detyruese, në lidhje me minorët të cilët janë gruplëndësh me zgjedhje, etj. Gjatë vizitës konstatuam se zgjedhja e minorëve ose e profileve bazohet në eksperiencën e viteve të shkuara sipas së cilës studentët kryesisht kishin preferuar minorët kundrejt profilit dhe kryesisht minorët e marketingut dhe të së drejtës së biznesit.</p> <p>Kriteri 3 Të gjitha njësitë e përmendura dhe në kriterin 1 i japin studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procesin mësimor, shpërndarjen javore të orëve në leksione, seminare, laboratore, etj. Ata informojnë studentët mbi detyrimet e frekuentimit të elementëve të mësipërm të zhvillimit të mësimin, pra leksione, seminare, laboratore, etj.</p> <p>Kriteri 4 Të gjitha njësitë e mësipërme japin gjithashtu informacion në lidhje me syllabuset e lëndëve/moduleve pjesë të planit mësimor të këtij programi studimi, pra Bachelor në Financë Kontabilitet.</p>

Konkluzionet e GVJ: Institucioni ofron programin e studimit në shqyrtim në këtë RVJ, Bachelor në Financë-kontabilitet në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Ky program studimi ka synuar të përafrohet maksimalisht me programet më të mira të studimit të fushës së financë-kontabilitetit që ofrohen në Europë dhe më gjerë dhe kjo përjasje ka bërë që ky program studimi të jetë i qendrueshëm ndër vite. Ndryshimi i vetëm thelbësor që i është bërë këtij programi studimi ka qenë ai i vitit 2011 me synim përshtatjen e tij me legjislacionin e ri. Prej vitit 2011 ky program studimi nuk ka ndryshuar në elementët thelbësorë të tij. Qendrueshmëria e planit mësimor për një periudhë relativisht të gjatë kohore është për tu vlerësuar dhe është reflektim i një pune serioze të kryer nga iniciuesit e këtij programi studimi si edhe nga hartuesit e syllabuseve të lëndëve/moduleve të tij, të cilat pavarësisht ndryshimeve të lektorëve mësimdhënës kanë mbetur të pandryshuara thelbësisht me kalimin e viteve akademike. Ky program studimi është pjesë e një diskutimi të vazhdueshëm vit pas viti për të qenë sa më pasqyruar dhe i përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe si rezultat i këtyre diskutimeve ka pasur ndryshime jo të strukturës së programit mësimor por të programeve të lëndëve apo moduleve, duke përfshirë në to leksioneve të hapura, orë laboratorike, detyra kursi, literaturë më bashkëkohore, etj. Informacioni në lidhje me programin ofrohet jo vetëm në institucion në të gjitha hallkat e tij por edhe në faqen e internetit të institucionit. Duhet treguar më shumë kujdes nga ana e institucionit në prezantimin e planit mësimor të këtij programi studimi. Kështu në materialin e RVB, në faqet 50-53 paraqitet plani mësimor i programit të studimit i ndarë në vite me të gjithë elementët e tij përbërës. Ky plan sipas gjykimit tonë është jo i plotë i paraqitur në këtë formë. Kështu në faqe 51 numër rendor 14 në kollonën e modulit paraqitet emërtim minorit/profili i zgjedhur ndërsa në kollonën lënda paraqitet lënda 1 dhe lënda 2 por në të tre faqet e planit mësimor nuk gjendet asnjë shpjegim se cilat janë alternativat e minorit apo profilit dhe cila është lënda 1 dhe 2 për secilën prej tyre. I njëjti arsyetim vlen dhe për vitin e tretë përkatësisht për lëndët 3 dhe 4. Duhet ndërhyrë gjithashtu në planin mësimor të paraqitur në materialin e RVB dhe në numrat rendorë të lëndëve të cilët nuk janë progresivë.

Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: **standardet në çështjen 7 "Politikat e formimit të studentëve" janë respektuar pjesërisht. Plani mësimor duhet të jetë i detajuar në lidhje me mundësitë e minorëve apo profileve që ofrohen dhe me lëndët përkatëse për gjithësecilin prej tyre. Një plan mësimor i detajuar duhet të jetë i lexueshëm dhe i kuptueshëm për të gjitha nivelet e studentëve (potencialë apo ata të regjistruar në këtë program studimi) pavarësisht asistencës ose jo të institucionit në tërësi dhe hallkave të tij në veçanti.**

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në SHLUJ UMB mësimdhënia është e organizuar në disa forma: kryesisht moduli apo lënda shihet si një kombinim i leksioneve, seminareve, laboreve, prezantim projekte kursi, analizë e rasteve hipotetike apo simulimeve të ofruara, etj. Gjithashtu në disa nga lëndët organizohen dhe leksione të hapura me ekspertë të fushës për të sjellë praktikën më afër njohurive teorike të përfituara gjatë zhvillimit të modulit/lëndës. Shpërndarja e ngarkesës në leksione dhe seminare është pothuajse e barabartë në këtë program studimi për të gjitha lëndët/modulet (885 orë në auditor leksione dhe 855 orë në auditor seminare), praktika mësimore është vlerësuar të zhvillohet me 90 orë në auditor. Kontrolli i njohurive kryhet nëpërmjet: testimit gjatë vitit dhe atij në fund viti, plotësimi të

detyrimeve si laboratore, detyra kursi, si edhe aktivizimit të studentëve në seminare, etj. Në lëndët/modulet që kanë të nevojshëm përdorimin e laboratoreve për zhvillimin e mësimin institucioni ofron ambientet e nevojshme ku mund të përdoret teknologjia në funksion të mësimdhënies. Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies kryhet nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë për këtë nivel, pra për nivelin bachelor. Format e vlerësimit të përdorura nga njësia janë të shumëllojshme: anketime të studentëve, vetëvlerësim i pedagogëve, etj. Studentët ftohen gjithashtu të jenë pjesë aktive e projekteve kërkimore-shkencore të iniciuara ose nga departamenti përgjegjës i programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ose nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë. Në Aneksin 8 në fund të këtij raporti ndodhen Tabelat 8, 8.1 dhe 8.2 mbi treguesit e matshëm të mësimdhënies.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
 - Leksione
 - Seminare
 - Ushtrime
 - Laboratore
 - Praktikë lëndore
 - Praktikë profesionale
 - Etj
- Format e kontrollit të njohurive
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Eksperti përshkruan gjëndjen e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për tu regjistruar në programin Bachelor në Financë Kontabilitet aplikantët duhet të kenë përfunduar shkollën e mesme. Pranohen gjithashtu dhe aplikantë të cilët transferohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë publik ose jo publik. Përzgjedhja dhe vlerësimi i aplikantëve kryhet nga një komision i krijuar nga institucioni, i cili klasifikon kandidatët në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ta si edhe nëpërmjet intervistimit ose testimit, kur komisioni e gjykon të nevojshme.

Cilësia e studentëve në hyrje në këtë program studimi ka qenë relativisht kostante duke variuar shumë pak ose aspak në vite. Kështu për periudhën 2009-2015 cilësia mesatare e studentëve në

hyrje është luhatur në intervalin 7.12-7.84. Numri i regjistrimeve në program ka pasur një tendencë rënëse në periudhën 2009-2013 për të vazhduar më pas me rritje për periudhën 2014-2015. Mesatarisht 50% e studentëve të regjistruar kanë përfunduar studimet pa vite shtesë ndërkohë që pjesa e mbetur rezultojnë me vite përsëritëse. Cilësia mesatare në dalje për studentët që kanë përfunduar studimet (vite regjistrimi 2009-2010, 2010-2011; 2011-2012 dhe 2012-2013) është shumë e përafërt me cilësinë mesatare në hyrje, një tregues i rëndësishëm i rigorozitetit të vlerësimit në këtë institucion për studentët e këtij programi studimi.

Në përgjithësi studentët e diplomuar ose janë punësuar mbas përfundimit të studimeve në këtë program studimi ose kanë vazhduar studimet master me shkëputje nga puna (në institucion ose jashtë tij) ose kanë vazhduar studimet master pa shkëputje nga puna (në institucion ose jashtë tij). Institucioni synon mbledhjen e statistikave në lidhje me punësimin e studentëve apo me aktivitetin e mëpasshëm të tyre duke kryer anketime ose sondazhe telefonike të herëpashershme. Sondazhi i fundit i kryer është organizuar në prill të 2016. Pavarësisht nëse studentët janë të punësuar apo jo, institucioni komunikon me të gjithë duke shfrytëzuar databazën e studentëve të diplomuar, për ti informuar në lidhje edhe me mundësi punësimi, apo aktivitete të tjera, për të cilat ata mund të jenë të interesuar. Për vlerësimin e treguesve të matshëm shih Tabelën 9 të Aneksit 9 bashkëlidhur këtij raport.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)
- Nota Mesatare
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)
- Nota Mesatare
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

➤ **Statistikë mbi punësimin, vazhdimin e studimeve etj. për të diplomuarit e programit.**

Eksperti përshkruan gjëndien e konstatuar në Institucion krahasuar me të dhënat e deklaruar nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Eksperti evidenton ndryshimet dhe shprehet nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardët/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------

IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteri 1 Pranimi në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe dhe aktet nënligjore dhe udhëzimet e MAS, të cilat për këtë vit akademik, pra 2016-2017, paraqiten me ndryshime thelbësore në reflektim të aplikimit të ligjit të ri të arsimit të lartë.</p> <p>Kriteri 2 SHLUJ UMB nuk ka propozuar kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë përfunduar Maturën Shtetërore për tu regjistruar në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Kriteri 1 Studentët informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e tij, kohëzgjatjen që në momentin e regjistrimit dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Informimi i tyre realizohet kryesisht nga pedagogët e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, pra Departamenti i Ekonomisë dhe Financës por edhe nga hallka të tjera të institucionit të dedikuara në funksion të punës me studentët si për shembull: zyra e këshillimit të karrierës, dekani i studentëve, zyra e aktiviteteve studentore, etj.</p> <p>Kriteri 2 Studentët marrin pjesë periodikisht në vlerësimin e pedagogut të lëndës së zhvilluar gjatë semestrit. Këto vlerësime zhvillohen dy herë gjatë vitit akademik dhe përgjithësisht në to ka një pjesëmarrje të konsiderueshme të studentëve, por jo pjesëmarrje të plotë, pavarësisht punës paraprake të zhvilluar nga institucioni për informim të studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces.</p> <p>Kriteri 3 Në institucion studentët kanë mundësi të këshillohen në lidhje me karrierën e tyre nga një zyrë e dedikuar për këtë shërbim që është zyra e këshillimit të karrierës. Në shërbim të këtij funksioni janë edhe hallka të tjera të institucionit si për shembull: departamenti përgjegjës për këtë program studimi, dekani i studentëve, zyra e aktiviteteve studentore dhe zyra alumni. Për të realizuar informimin e studentëve në lidhje me ciklet e mëpasshme të studimit, informimin e tyre në lidhje me mobilitete jashtë vendit, orientimin e studentëve në tregun e punës, organizohen përgjatë gjithë ciklit të studimeve leksione të hapura me</p>


	<p>ekspertë të fushës, konsultime me të gjitha strukturat e sipërcituara, shpërndarje e praktikave mësimore në funksion dhe të qëllimit të përbashkët institucion-student, punësimit sa më të shpejtë dhe në përputhje me profilin e shkollimit të studentit, pra në profilin e financë-kontabilitetit.</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen në lidhje me mundësitë që ju ofrohen pas përfundimit të këtij programi studimi. Në funksion të këtij qëllimi departamenti përgjatë vitit akademik 2015-2016 kishte organizuar një leksion të hapur me studentët për ti orientuar në lidhje me mundësitë që mund të shfrytëzonin në tregun e punës duke qenë të pajisur me diplomën e bachelorit apo kombinimit të saj me diplomat e mundshme të ciklit të dytë të studimeve dhe përkatësisht masterit shkencor apo masterit profesional. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe shumë aktivitete të tjera të organizuara nga institucioni, si leksione të hapura me ekspertë, të ftuar të rëndësishëm, etj por gjithashtu edhe njoftimet e ndryshme të përcjella te studentët në lidhje me mundësi të ndryshme punësimi.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve; Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Kriteri 1 SHLUJ UMB disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në këtë program studimi, pra Bachelor në Financë Kontabilitet. Kriteri 2 SHLUJ UMB disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program, transferimet në të të studentëve nga IAL të tjera dhe anasjelltas, largimet para përfundimit të programit, ripranimet, etj. Kriteri 3 SHLUJ UMB disponon të dhëna për ecurinë e studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre, frekuentimin e lëndëve të ndryshme, vlerësimin përkatës të lëndëve, praktikës mësimore, diplomë/provim formimi e kështu me rradhë.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Kriteri 1 SHLUJ UMB u ofron këshillim karriere studentëve të regjistruar në programin Bachelor në Financë Kontabilitet, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në informimin dhe në përzgjedhjen e të gjithë elementëve që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Këtë funksion institucioni e kryen kryesisht nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës por edhe nëpërmjet departamentit që</p>

	<p>manaxhon këtë program studimi pra Departamenti i Ekonomisë dhe i Financës.</p> <p>Kriteri 2 SHLUJ UMB ndihmon studentët në përzgjedhjen e kompanisë/organizatës/institucionit ku do të zhvillojnë praktikën mësimore, disiplinë përmbyllëse e ciklit të parë të studimeve, përpara mbrojtjes së diplomës/provim formimi. Kjo gjë realizohet duke u mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi të SHLUJ UMB (mund të veçojmë në funksion të profilit të këtij programi studimi marrëveshjet e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Bankën Credins, Drejtorinë e Doganave, Ernst & Young Certified Auditors, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, etj). Hallkat e institucionit të fokusuar kryesisht për realizimin e këtij qëllimi janë: zyra e këshillimit të karrierës si edhe Departamenti i Ekonomisë dhe i Financës.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ: SHLUJ UMB respekton legjislacionin në fuqi në lidhje me regjistrimet e studentëve në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Aktualisht, pra për vitin akademik 2016-2017 nuk ka kritere të veçantë të pranimit të aplikantëve në këtë program studimi. Institucioni informon studentët në lidhje me të gjithë elementët e nevojshëm për këtë program studimi. Informimi kryhet jo vetëm nga hallkat institucionale të IAL por edhe elektronikisht në faqen web të institucionit. SHLUJ UMB, dhe specifikuisht Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, mban një bazë të dhënash në lidhje me studentët për elementë si: cilësia e tyre në hyrje, ecuria e tyre përgjatë studimeve, cilësia e tyre në dalje, punësimi i tyre, etj. Mbetet problem për këtë program studimi, numri relativisht i ulët i studentëve në hyrje si dhe cilësia e tyre, pavarësisht punës shumë të madhe të kryer nga institucioni për rekrutimin e më të mirëve të maturës shtetërore. Theksojmë se ky nuk është problem vetëm i këtij programi studimi, apo i programeve të tjera të studimit që ofron SHLUJ UMB, por një problem i hasur pothuajse në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend. Përpjekjet e institucionit për të tërhequr më të mirët janë maksimale. Kështu fushata informuese të maturantëve kryhen për një periudhë 6 mujore nga institucioni dhe mbulojnë jo vetëm Tiranën dhe rrethinat e saj por edhe qytetet e tjera të Shqipërisë. Këtij qëllimi, tërheqjes së më të mirëve, i ka shërbyer dhe dhënia e bursave nga institucioni jo vetëm për regjistrim të maturantëve më të mirë në vit të parë të bachelorit por dhe për stimulimin e tyre me bursa mbështetëse për vitet e tjera të studimit. Në sajë të një pune të konsiderueshme në këtë drejtim nga ana e institucionit numri i synuar i regjistrimeve për vitin akademik 2016-2017 në programin në shqyrtim është 50 studentë. Për sa shpjeguar më sipër konkludojmë që: standardet në çështjen 9 “Studentët” janë respektuar plotësisht.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore



Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

SHLUJ UMB ka një politikë të kërkimit shkencor, si edhe struktura të posaçme të kërkimit për përmbushjen e kësaj politike. Politika e kërkimit shkencor si dhe hallkat e kërkimit të IAL janë në shërbim edhe të programit të studimit në shqyrtim. Një ndër objektivat kryesorë të IAL në fushën e kërkimit shkencor, është realizimi i kërkimeve cilësore nga pedagogët në fushat e veprimtarisë që ata mbulojnë, kjo jo vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin por edhe me pedagogë të IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit, si edhe me ekspertë të fushës. Politika e kërkimit shkencor të SHLUJ UMB realizohet në përputhje me standardet e EQUIS në kategoritë e: kërkimit akademik, kërkimit të orientuar drejt praktikës, zhvillimit dhe inovacionit teknologjik. Aktiviteti kërkimor i institucionit në fushën e botimeve përfaqësohet nga botime në formën e: monografive, botime në revista shkencore mbështetëse të programit, artikuj të botuar në revista të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit, etj. Projektet kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, në të cilat janë përfshirë pedagogë të departamentit janë disa. SHLUJ UMB informon studentët në lidhje me kërkimet më të fundit të realizuara nga pedagogë të institucionit. Institucioni i ofron studentëve informacione për mundësitë që ofrohen në arsimimin e tyre të mëtejshëm nga universitete brenda dhe jashtë vendit dhe i mbështet studentët në procesin e tyre të aplikimit në këto institucione. Për vlerësimin e treguesve të matshëm shih Tabelën 10 të Aneksit 10 bashkëlidhur këtij raporti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të fituara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave
 - Aktiviteti kërkimor dhe kualifikimi shkencor i stafit;
 - Lista e aktiviteteve Financë-Kontabilitet 2011-2016.

